



KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me:		
Prilbjen:		
18.03 2024		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-016/d-15228		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e Kryetarit të Komunës

PROCEVERBAL

NGA DRAFT-PLANI LOKAL I

VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN

E KOMUNITETEVE ROM

DHE ASHKALI I

KOMUNËS SË LIPJANIT 2024-

2026

Procesverbal nga Draft-Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali i Komunës së Lipjanit 2024-2026

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

HYRJE

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021 Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë dhe me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për Draft-Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali i Komunës së Lipjanit 2024-2026) dhe Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Draft-Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali i Komunës së Lipjanit 2024-2026)

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike dhe linku i platformes për konsultime publike të Qeverisë së Kosovës, ku ka qenë në diskutim publik Draft Plani si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/konsultimet-publike/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42286>

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=781449004009450&set=pb.100064330733832.-2207520000&type=3>

<https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2024/02/Njoftim-per-debat-Publik.pdf>

Procesverbal nga Draft-Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali i Komunës së Lipjanit 2024-2026

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Nën kryesimin e Nënkryetarit të Komunës Diamant Bytyqi njëherit edhe kryesues i komisionit për hartimin e këtij Plani u hap takimi me ç'rast ai ka përshëndetur të gjithë të pranishmit duke i falenduar për pjesëmarrje ka thënë se ky plan veprimi është hartuar në përputhje me sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Lipjanit, të cilët janë caktuar nga Kryetari i Komunës, si zyrtarë të drejtorive të ndryshme komunale, si dhe përfaqësues të OJQ-ve dhe të grupeve avokuese që merren me çështjet e komuniteteve rom, ashkali në këtë komunë..

Për realizimin e këtij plani lokal të veprimit, Kryetari i Komunës së Lipjanit kanë marrë vendim për themelimin e Komitetit Komunal Veprues me datë 16.02.2023, për hartimin e "Planit Lokal të Veprimit, ku përfshihen Komuniteti Rom dhe Ashkali 2023-2026, në Komunën e Lipjanit", me këtë përbërje:

1. Diamant Bytyqi – Nënkryetar i Komunës– Kryesues
2. Rasim Hasani – Drejtor i Drejtoratit për Arsim, anëtar
3. Shkëlzen Hajdini – Drejtor i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Socile, anëtar
4. Albert Mustafa – Shef i Sektorit DSHPS dhe zyrtar përgjegjës nga fusha e banimit, anëtar
5. Lidija Jovanovic, – Zyra Lokale për Komunitete
6. Fjolla Ibrahim – QPS dhe zyrtare për mbrojtjen e fëmijës
7. Hasan Luma – Zyrtar për barazi gjinore
8. Shahadije Ibrahim – Shefe e Sektortit për Buxhet dhe Financa
9. Sunaj Garip – OJQ- "All Youth Together, anëtar
10. Adelina Qorraj Emini – OJQ- Women 'Alliance for integration ", anëtare
11. Majlinda Krasniqi – OJQ "The ideas Partnership", anëtar
12. Shkelqim Bahtiri- OJQ "Ipko foundation", , anëtar

Konsultimi publik u zhvillua në prezencën e një numër të konsideruar të pjesëmarrësve, me ç'rast kryesuesi Bytyqi ka theksuar se me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse, ka prezantuar Projekt-Planin Komunal Planit Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Lipjanit 2024-2026, duke thënë se Procesi i hartimit të deri te miratimi i këtij dokumenti nga Kuvendi i Komunës i Lipjanit kemi kaluar nëpër disa faza, nëpër të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme.

Procesverbal nga Draft-Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali i Komunës së Lipjanit 2024-2026

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Kryesuesi Diamant Bytyqi, duke e prezantuar këtë plan ka thënë se Komuna e Lipjanit është komuna në të cilën jetojnë rreth 57605 banorë ku prej tyre 3.67% i përkasin komuniteteve rom dhe ashkali. Situata e përgjithshme e këtyre komuniteteve në këtë komunë vlerësohet të jetë e ngjashme me shumicën e komunave tjera ku jetojnë këto dy komunitete dhe konsiderohet se ende ka nevojë për përmirësimin e situatës së tyre në shumë fusha e drejtime, andaj kërkohet një fokus më i madh i Komunës së Lipjanit në këtë drejtim.

Bazuar në strategji dhe plan veprimi përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë Kosovare 2022-2026. Komuna e Lipjanit e bëri hartimin e këtij “Plani Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Lipjanit 2023-2026”. Ky plan veprimi është hartuar bazuar kryesisht në sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Lipjanit, të cilët janë caktuar nga vet komuna, si zyrtarë të drejtorive të ndryshme komunale, si dhe përfaqësues të OJQ-ve dhe të grupeve avokuese që merren me çështjet e komuniteteve rom dhe ashkali në këtë komunë, të cilët e kanë themeluar Komiteti Komunal Veprues për hartimin e këtij plani lokal të veprimit.

Pas konsultimeve dhe diskutimeve që ka zhvilluar Komiteti Komunal Veprues për hartimin e planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali 2024-2026 në Komunën e Lipjanit, ka vendosur që në kuadër të këtij plani të veprimit të përfshihen pesë fusha kryesore, të cilat janë edhe pjesë e strategjisë shtetërore në nivel të Kosovës “Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2024– 2026”.

Komiteti Komunal Veprues ka vendosur që në kuadër të planit lokal të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali, 2024-2026 në Komunën e Lipjanit të përfshihen pesë fushat në vijim:

- Arsimi
- Punësimi dhe mirëqenia sociale
- Shëndetësia
- Banimi
- Diskriminimi

Diamant Bytyqi po ashtu ka njoftuar te pranishmit se punësia e parë për analizën e gjendjes për këto pesë fusha është organizuar më 02 maj 2023 nga OSBE, dhe në të kanë marrë pjesë përfaqësues: Zyra për qeverisje të mirë, anëtarët e Komiteti Komunal Veprues të Komunës së Lipjanit, dhe organizata jo-qeveritare që punojnë me komunitetet rom dhe ashkali në këtë komunë. Kjo punëtori është moderuar nga konsulentë dhe gjatë saj është bërë një analizë e gjendjes ekzistuese e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Lipjanit për këto pesë fusha.

Procesverbal nga Draft-Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali i Komunës së Lipjanit 2024-2026

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Tutje nënkryetari i komunës tha se në pjesën e parë, Komitetin Komunal Veprues ka përcaktuar vizionin, misionin, vlerat dhe parimet mbi të cilat ndërtohet ky plan veprimi. Tutje, për të gjitha fushat e përfshira në këtë plan veprimi është bërë analiza e gjendjes, janë identifikuar sfidat kryesore, janë përcaktuar objektivat strategjike, janë përcaktuar rezultatet e pritshme, si dhe janë caktuar dhe përshkruar aktivitetet e parapara, realizimi i të cilave do të ndikojë në përmirësimin e situatës së përgjithshme të këtyre komuniteteve në Komunën e Lipjanit. Po ashtu, janë përcaktuar edhe treguesit për secilin objektiv, si dhe është bërë një identifikim dhe përshkrim i supozimeve dhe rreziqeve që ndikojnë në zbatimin e këtij plani të veprimit.



Procesverbal nga Draft-Plani Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali i Komunës së Lipjanit 2024-2026

INFORMATË RRETH DEBATIT PUBLIK

Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë çështje, lidhur Planin Lokal i Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali i Komunës së Lipjanit 2024-2026.

Gjatë këtij debati ka pasur edhe angazhime nga të pranishmit ku është diskutuar për çështjet të ndryshme dhe kanë kërkuar nga komisioni sqarime rreth këtij dokumenti.

Ne po i paraqesim pyetjet që janë parashtruar në mënyrë elektronike nga OJQ-së "Advancing Together" (AT) dhe Programi për të Drejtat Civile Kosovë – CRP/K-ë, partner i zyres së UNHCR-së në Kosovë dhe Mentor Seferi (CRPK)

Driton Bakraci nga OJQ "Advancing Together" (AT)

- Mungon analiza e gjendjes, objektivat, rezultatet, aktivitetet dhe plani i veprimit në lidhje me Diskriminimin. Diskriminimi është një ndër objektivat kryesore të Strategjis për avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2026 dhe planit të veprimit 2022-2024.

Komisioni pas shqyrtimit e ka miratuar këtë koment dhe ka shtuar edhe një fushë tjetër diskriminimi

Driton Bakraci nga OJQ "Advancing Together" (AT)

- Në planin e veprimit mungojn aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen e EPRBM. Në analizen e gjendjes është konstatuar që ky mekanizëm nuk kanë qenë mjaftueshëm i angazhuar për parandalimin e braktisjes të fëmijëve nga shkollimi. Ju lutem referojuni objektivit specifik 1.1.3 tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2024.

Komisioni ka theksuar se kanë bërë një plan ekstra për mos braktisjen e shkollës

Driton Bakraci nga OJQ "Advancing Together" (AT)

- Planin e veprimit duhet të adresoj çështjen e regjistrimit civil të komuniteteve përmes aktiviteteve të caktuara si identifikimin, regjistrimin, lirimi nga taksa, si dhe referimin e rasteve komplekse tek institucionet relevante. Regjistrimi i lindjes dhe shtetësisë paraqet të drejtën elementare civile në jetën e pjesëtarëve të komuniteteve e cila u mundëson qasjen në të drejta dhe shërbime. Ju lutem referojuni Objektivit specifik 5.1.5 tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali.

Pergjigje nga Komisioni ka pranuar komentin duke thënë se lirimi nga taksa bëhet 1 herë në vit gjatë muajit prill

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Të verifikohet me Zyren Komunale për Komunitete dhe Kthim se a janë të përfshira 4 (3 Ashkali/1Rome) familje të kthyer nga rajoni, që kanë nevojë për banim dhe regullimin e çështjeve pronësore.

Komisioni ka pranuar komentin duke theksuar se **e verifikojnë zakonisht në bashkëpunim me ZKKK**

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Të parashihen aktivitete specifike në ngritjen e kapaciteteve të Komunës në përdorimin e platformes elektronike për banim social, krijimin e listës së nevojave me prioritet për banim social, ofrimin e ndihmave juridike falas gjatë procesit të legalizimit dhe fushatës për promovimin për të drejtat e banimit. Ju lutem referojuni Objektivave specifik 4.1 dhe 4.2 tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2024.

Komisioni ka pranuar dhe ka potencuar se sipas planit është regulluar me zyren ndihma juridike falas

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Plan i zbatimit, operacionalizimi i aktiviteteve, periudha e zbatimit dhe buxheti duhet të jetë për vitet 2024-2026, e jo 2018-2022. Me siguri është përvjelur ndonjë gabim teknik, që pamundëson rishikimin e planit të zbatimit në mënyrë adekuate.

Komisioni ka pranuar komentin duke potencuar se tashmë **jane evituar të gjitha gabimet teknike**

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Të shtohet aktiviteti specifik mbi monitorimin e implementimit të udhëzimit administrativ për lehtësimin e kriterëve për regjistrimin e fëmijëve në institucione parashkollore publike. Ju lutem referojuni objektivit specifik 1.1.1. tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2024.

Komisioni ka pranuar komentin duke thënë se janë paraparë **takimet që do të realizohen në mënyrë sistematike gjatë vitit shkollor por një theks i veçantë i kushtohet periudhave gjatë regjistrimit dhe përfundimit të çdo gjysmë vjetor shkollor.**

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Të parashihet aktivitet specifik mbi ngritjen e kapaciteteve, apo mbështetje për Ekipet për Parandalimin e Braktisjes dhe Mosregjistrimit në Shkollë. Ju lutem referojuni objektivit specifik 1.1.3 tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2024.

Komisioni ka pranuar komentin dhe ka potencuar se kemi një plan ekstra **kunder braktisjes së shkollës**

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Të shtohet aktivitetet specifik mbi hulumtin e nevojave për arsimimin e të rriturve. Ju lutem referojuni objektivit specifik 1.1.9 tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2024.

Komisioni ka pranuar pjesërisht komentin duke thënë se nuk ka numer të mjaftueshëm të nxënësve por kemi në plan si aktivitetet dhe nvalet prej numrit te nxënësve sa aplikojnë.

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Të shtohet aktivitetet specifik në lidhje me organizimin e programeve të lexim-shkrim për të rritur. Kjo do të mundësoj angazhimin e të rriturve në edukimin e fëmijëve në të ardhmen. Ju lutem referojuni objektivit specifik 1.1.12 tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali

Komisioni ka pranuar pjesërisht komentin duke thënë se si aktivitet është tek pjesa e mosbraktisjes së shkollës dhe sepse shkrim- leximi mesohet gjatë vijimit nëpër shkolla ne për këtë arsye nuk e kemi parë të arsyeshme të jetë si aktivitet i veçantë në plan.

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Të parashihet edhe ofrimi i ndihmave sociale për familjet që nuk kanë arritur të punësohen, dhe ndihmave emergjente. Ju lutem referojuni objektivave specifike 2.2.7 dhe 2.2.8 tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2024

Komisioni ka pranuar komentin dhe ka thënë se tashmë veq se janë të përfshira këto ndihma, dhe do të vazhdojnë të jenë çdo herë si ndihmat emergjente.

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Të organizohen takimet e rregullta të Tryezave për Ndihmë në Menaxhimin e Rasteve të fëmijëve në rrezik të mesëm apo të lartë. Ju lutem referojuni objektivit specifik 2.2.9 tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2024.

Komisioni ka pranuar komentin dhe tha se takimet do të mbahen si çdo herë nga departamenti për mbrojtje dhe shërbime.

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Të parshihet përfshirja e përfaqësuesit të komuniteteve në Këshilin e Pacientëve në Komunë. Ju lutem referojuni objektivit specifik 3.2.2 tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2024.

Komisioni ka pranuar komentin dhe ka thënë se nga 5 antarë gjithësejtë nga këshilli e pacientëve 2 prej tyre janë nga komuniteti ashkali.

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Të ofrohen trajnime stafit shëndetësor për mos diskriminim në ofrimin e shërbimeve dhe të organizohen fushata ndërgjegjësuere për të drejtat e pacientit dhe mekanizmit të ankesave. Ju lutem referojuni objektivave specifike 3.3.1 dhe 3.3.2 tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2024.

Komisioni ka pranuar komentin dhe ka thënë se do të parashihen në plan organizimi i trajnimeve të veqanta nga stafi shëndetësor për vaksionim si dhe shërbime të tjera të nevojshme.

Driton Bakraci nga OJQ “Advancing Together” (AT)

- Ky aktivitet duhet të jetë më i detajuar:
 1. Të organizohen tryeza ndërgjegjësuere për pasojat e martesave dhe lindjeve të hershme, planifikimi familjar, menopauza, kanceri në mitër. Ju lutem referojuni objektivit specifik 3.2.4 tek plani i veprimit të Strategjis për avancimin e drejtave të komuniteteve Rom dhe Ashkali 2022-2024.
 2. Ligjërata ndërgjegjësuere për promovim shëndetësorë dhe parandalimin e sëmundjeve kronike dhe ngjitëse, ushqyeshmëri. Ju lutem referojuni objektivit specifik 3.2.3
 3. Të shpërndahen materiale informuese për planifikim familjar dhe shëndet riprodhues. Ju lutem referojuni objektivit specifik 3.2.6

Komisioni ka pranuar komentin duke thënë se janë paraparë aktivitetet si: 1. Programi, “ Kujdesi për Nënën”, ekipet grupore do të bëjnë vizita për nënat në shtëpi duke ju jap ligjerata për problemet shëndetsore që vinë si pasoj e lindjeve të hershme 2. Ne do të organizojm ligjerata për sëmundjet kronike, sëmundjet ngjitëse TB, Hepatit, dhe sëmundjet jo ngjitëse Hipertension, Diabet, Asma etj. 3. Do të ofrojmë ligjerata për shëndetin riprodhues.

Mentor Seferi (CRPK)

- Kërkesa e jonë është që në” Plani lokal i veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali i Komunës së Lipjanit 2024-2026 ”: përbrenda të katër ojektivave strategjike (Arsimi, Punësimi- mirëqenia sociale, Shëndetësia dhe Banimi) të shtohet një paragraf që do të përfshinte komentin si në vijim:

Duke pasur parasysh faktin se të drejtën për të qënë përfitues i shërbimeve dhe të drejtave të parapara me këtë plan lokal janë vetem personat të cilët posedojnë dokumente personale të Kosovës (certifikat/ekstrakt të lindjes, letërnjoftim), është me rëndësi të theksohet se ka pjesëtarë të komuniteteve Rom dhe Ashkali që ende nuk e kanë të zgjidhur çështjen e regjistrimit të lindjes në regjister të gjendjes civile, pra nuk posedojnë dokumete personale nga gjendja civile (certificate/ekstakt të lindjes) dhe letërnjoftim. Prandaj është e rëndësishme që regjistrimit të lindjes dhe pajisjes me letërnjoftim ti kushtohet kujdes i veçant, që përbrenda secilës nga katër objektivat të përfshihet një pragraf i cili paraprakisht do të adresonte çështjen e pjesëtareve nga komunitet Rom dhe Ashkali te cilet kanë lindur në territorin e komunes se Lipjanit dhe nuk janë të regjistruar në regjistrin e lindjes të gjendjes civile dhe nuk posedojnë dokumete personale të Kosoves (certificate/ekstrakt te lindjes dhe leternjoftim). Pa posedim te dokumenteve të gjendjes civile (certificate/ ekstrakt të lindjes dhe letërnjoftim), këta persona janë të privuar nga qasja në të drejtat dhe shërbimet të përcaktuara me këtë plan lokal.

Komisioni ka pranuar komentin dhe rekomandimet e organizates në fjalë i ka përfshirë në këtë projekt plan.

Takimi filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 11:30

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuuesve
30 ditë pranohen		13
30 ditë		

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 13 pjesëmarrës, prej tyre femra 7 dhe 6 meshkuj.

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike